

NJOFTIM KONKURIM PËR VEND PUNE

Referuar nenit 199, të Ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Ministria e Kulturës shpall konkursin publik për pozicionin:

- Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar, kategoria e pagës II-1.
***Afati për dorëzimin e dokumenteve pranë Zyrës së Protokollit, në Ministrinë e Kulturës deri ne datë 29.01. 2024.**

Përshkrimi përgjithësues i punës:

- a) Përçimi i historisë së vendit, i cili ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e identitetit kombëtar, zhvillimin e rolit edukativ dhe në përcjelljen e këtij imazhi te vizitorët; studimi, kërkimi, konceptimi, projektimi, mbikëqyrja, konservimi, restaurimi, promovimi, publikimi, konsulenca dhe bashkëpunimi me subjekte publike e private, shqiptare apo të huaja, në fushën e tematikës.
- b) Nxitja e dialogut midis qytetarëve për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen shqiptare. Për këtë qëllim, ai përfton, ruan e studion provat materiale dhe jomateriale të trashëgimisë historike e kulturore të Shqipërisë, të cilat i komunikon dhe i paraqet në një mjedis që nxit edukimin dhe argëtimin.
- c) Ekspozimi i fondit të MHK-së, zhvillimi i aktiviteteve ekspozuese dhe hapja e ekspozitave të përkohshme.
- d) MHK-ja mund të krijojë shoqatën e miqve të muzeut, e cila ka për qëllim dhënien e një kontributi moral e financiar në zhvillimin e veprimtarive dhe të projekteve të edukimit nëpërmjet artit të ndërmarra nga institucioni, si dhe çdo lloj projekti tjetër. Marrëdhënia e anëtarëve me institucionin parashikohet në aktet e themelimit dhe vendimet e shoqatës.

Objektiva në Administrim

- a) Të sigurojë ligjshmëri dhe transparencë të kontratave individuale dhe procedurave të punësimit;
- b) Të ndërtojë një plan buxhetor financiar të qartë vjetor;
- c) Të bëjë të mundur rritjen e të ardhurave përmes burimeve të treta;
- d) Të ngrejë një sistem treguesish vlerësimi të punës së institucionit për të lehtësuar dialogun me Ministrinë e Kulturës;
- e) Është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe detyrave të veçanta të stafit;
- f) Mbikëqyr veprimtarinë e tyre dhe garanton koordinim dhe bashkëpunim me njësitë e tjera organizative;

- g) Siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat duke ndjekur rregullisht procesin dhe duke marrë masa për zgjidhjen e problemeve;
- h) Siguron përdorimin eficient të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin dhe arritjen e objektivave;
- i) Zgjidh probleme të ndryshme dhe komplekse, që ndikojnë në realizimin e objektivave institucionale;
- j) Vendimmarrja është strategjike, konstante, komplekse në përputhje me kuadrin ligjor;
- k) Siguron organizimin e tillë të punës që mundëson vazhdimësinë e shërbimit;
- l) Koordinon dhe harton plane zhvillimi në përputhje me strategjinë afatshkurtër dhe afatgjatë të institucionit;
- m) Organizon së bashku me specialistët e muzeut veprimari me karakter kulturor dhe edukativ për publikun e gjerë;
- n) Nxist bashkëpunimin me institucione shkencore vendase dhe të huaja;
- o) Përcakton numrin, vendin, llojin dhe veprimitaritetë turistike, kulturore dhe argëtuese në territorin e Muzeut në bazë të një plani të caktuar duke koordinuar me Ministrinë e Kulturës, agjensi turistike, shoqata dhe organizma të tjera të interesuara si dhe me pushtetin lokal.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e konkurimit publik:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
- c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
- d) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- e) Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;
- f) Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:

- a) Të ketë arsim universitar të nivelit *Master Shkencor* në shkencë shoqërore;
- b) Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në drejtim dhe eksperiencë në fushën e trashëgimisë kulturore, të vërtetuar me dokument;
- c) Të njohë problemet aktuale dhe sfidat e muzeologjisë me qëllim reformimin e tij përkrah modeleve më të mira bashkëkohore;
- d) Të ketë përvojë në ndërtimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve me donatorë dhe grupe të tjera të interesit.

- e) Të ketë aftësi të dallueshme komunikimi në ruajtje dhe zhvillim të kontakteve brenda dhe jashtë institucionit, si dhe me partnerët vendorë e ndërkombëtarë;
- f) Të ketë përvojë në programe të Edukimit Përmes Kulturës, ose programe të ngjashme brenda ose jashtë vendit;
- g) Të njoh legjislacionin kombëtar, europian dhe atë ndërkombëtar në fushën e muzeologjisë dhe të trashëgimisë kulturore.
- h) Të ketë njohuri të gjuhës angleze. Zotërimi i një gjuhe të dytë të BE-së përbën avantazh.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Jetëshkrimi CV;
- b) Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;
- c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g) Dokument që vërteton njohuritë e gjuhës angleze.
- h) Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Kandidati duhet të propozojë një platformë për mirëadministrimin e veprimtarisë së Muzeut Historik Kombëtar dhe adresimin e sfidave aktuale në fushën e muzeologjisë, duke mbajtur në konsideratë edhe vendimin nr. 540 datë 08.11.202, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, të projektit “Për Rikonstruksionin Rikonstruksioni dhe Muzealizimi i Muzeut Historik Kombëtar”.